



QENDER KËRKIMORE SHKENCORE

# PERMBLEDHJE JO TEKNIKE

SHFRYTËZIM I GURIT GËLQEROR NGA

**KOMPANIA "PASHA - X" SH.P.K,**

Përgatitur nga Departamenti i Gjeomjedisit - G & G GROUP



**AUTORË:**

**Prof. asc. SAZAN GURI** Ekspert Gjeomjedisi

**Ing. Dipl. Marianthi GURI** Ekspert mjedisi

**Msc. Denisa BALO** Eksperte e shëndetit publik

**Tiranë, Gusht – 2018**

## Të dhënat e mbajtësit të lejes

Në zbatim të Nenit 32 të ligjit Nr. 10431, dt. 09.06.2011, "Për Mbrojtjen e Mjedisit, VKM-së Nr. 742 dat 09/09/2015 "Për funksionimin dhe menaxhimin e Regjistrimit të Shkarkimit e Transferimit të Ndotësve, si dhe e formatit të aktit të miratimit të Lejeve Mjedisore "Shoqëria PASHA X" sh.p.k. me vendndodhje në Ndertes private 1 katëshe pranë Komunës Thumanë, Koder Thumanë. 2, Krujë, me administrator z. Hamdi Pasha, që ushtron aktivitetin e Shfrytëzimit të gurit gëlqeror nga guroret me punime sipërfaqesore, "Industria minerare", ID 3.7, Nxjerrja e Mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret, Titulli i instalimit sipas Shtojcës 1, të Ligjit Nr. 60/2014, datë 19.6.2014 dhe ligjit nr. 10 448, date 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" të ndryshuar":

	ID	Veprimtaria	Kapaciteti kufi për lejet e Tipit A	Kapaciteti kufi për lejet e Tipit B	Kapaciteti kufi për lejet e Tipit C
Industria minerare	3.7	Nxjerrja e Mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur <b>dhe nga guroret</b>	_____	Të gjitha instalimet; Kapaciteti i projektuar 110 000m <sup>3</sup> /vit	_____

me kapacitet të projektuar 110000 m<sup>3</sup>/vit dhe sipërfaqja totale ku zhvillohet aktiviteti është 0.18km<sup>2</sup>, me Vendndodhje Burizane, Zona minerare konkurruese Nr. 379/2, Qarku Durrës, paraqet raportin vjetor të mjedisit e të dhënave për shkarkimet dhe transferimin e ndotësve mjedisor.

Studio "G & G group", e përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv z. Sazan GURI, e regjistruar me Vendimin e Gjykatës së Tiranës Nr. 28402, datë 19.04.2004, me seli qendrore në Rr. Zef Jubani, Pall. Bjorn, Minibashkia Nr.5, Tiranë, që kryen studime, projektme e konsulta në fushat e Mjedisit, të Gjeoshkencës, person fizik, dhe ECCAT sh.p.k., Person Juridik, me Çertifikat të akredituar me Nr. LT.046 e vlefshme deri në 11/11/2019, që kryen veç të tjerave dhe analiza të kampioneve për efekt monitorimi në ujë e tokë dhe zhurma e përfaqësuar nga Administratori, znj. Eralda Dano.

Nga **investitori**, që kërkon të ushtrojë këtë aktivitet, konsulenti mori përsipër kryerjen e raportin vjetor të mjedisit e të dhënave për **shkarkimet** dhe transferimin e ndotësve, në mbështetje të një aktiviteti të qëndrueshëm ekonomik të zonës në studim. Relacioni është përgatitur në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe me kërkesat e sotme të Institucioneve Financiare Ndërkombëtare dhe standartet e aplikueshme të Bashkimit Europian. Ky raport siguron një vlerësim të mjedisit rreth zonës së këtij aktiviteti dhe hedh dritë mbi masat që nevojiten për të parandaluar, minimizuar, zbutur apo kompesuar një ndikim të mundshëm negativ mjedisor dhe për të përmirësuar realitetin mjedisor. U rishikuan studimet topografike, gjeoteknike, hidrogjeologjike, gjeorrezive, etj., ku u hodh dritë mbi konceptet bazë të rreziqeve natyrore tokësore dhe dëmeve që rrjedhin nga funksionimi i këtij aktiviteti.

**Objektivi i përgjithshëm** është realizimi i raportit vjetor të mjedisit e të dhënave për **shkarkimet** dhe transferimin e ndotësve, si një proces që zhvillohet gjatë funksionimit të këtij impianti, duke parashikuar dhe planifikuar treguesit e ndikimeve të saj në mjedisin fizik, social, human dhe financimet. Objektivat që synohen të arrihen janë:

- Të ushtrojë aktivitetet të biznesit në Shfrytëzimin në qiell të hapur të gurit gëlqeror nga guroret.
- Përmirësimin e vlerave ekologjike e rikrijuese të territorit, gjatë funksionimit të këtij aktiviteti.

- Identifikimin e uljes së nivelit të ndotesve atmosferike;
- Pakesimin dhe menaxhimin sa më të mirë të mbetjeve të ngurta;
- Zbulimin e ndryshimeve dhe përcaktimin saktësisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit të mineraleve natyrore;
- Sigurimin e informacioneve mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) të burimeve dhe shkaqeve të tyre;
- Evidentimin e cilesisë së mjediseve përreth zones së minierës për të marrë masat e nevojshme për permiresimin e tyre;
- Për vlerësimin e efektivitetit të politikave dhe veprimeve për menaxhimin e burimeve minerare natyrore.

### Metodologjia e përdorur

Për realizimin e raportit vjetor të mjedisit e të dhënave për shkarkimet dhe transferimin e ndotësve u kryen vrojtime në terren në një rajon të gjerë, duke kryer vrojtime pedologjike, hidrologjike, ekologjike, si edhe të biodiversitetit. Për realizimin e objektivave të këtij relacioni janë marrë:

- Foto në territorin në studim;
- Takime me ekspert lokalë dhe komunitetin e zonës;
- Analiza si më poshtë:
  - a. për shkarkimet e lëngëta në ujërat sipërfaqësore (pH, lëndët pezull, turbullira, COD, azoti total, fosfate);
  - b. ndotjen akustike.
  - c. për ndotjen e ujërave nëntokësore (shija dhe era, ngjyra dhe pamja e jashtme, pH, konduktiviteti elektrik, Ca<sup>++</sup>, lëndët pezull, turbullira, alkaliniteti total, karbonate, bikarbonate, amonjaku, nitrite, nitrate, fortësia totale, fosfate, lënda organike, kloruret, sulfate, TDS, Mg<sup>++</sup>);
  - d. për lëndët në pezulli në ajër;
  - e. për shkarkimet e gazta e aromat në ajër;

<b>Lista e veprimtarive</b>	
Veprimtaritë kryesore	Përshkrimi i veprimtarisë së specifikuar
Sistemi i shfrytëzimit në minerë	Procesi teknologjik i prodhimit të guri gëlqeror në kariere është i thjeshtë. Shfrytëzimi do të bëhet nga lartë poshtë nga shkalla e parë +170 deri +180, duke u ulur çdo 10m deri në shkallen fundore. Kjo mënyrë shfrytëzimi ka përparësi të mëdha krahasuar me variantet e tjera, ka komoditet në hapjen dhe shfrytëzimin e karieses, të lejon rritjen e prodhimit në vartësi të kërkesave është me i sigurt për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik, mbrojtjen në punë, e tjera. Optimimi i guri gëlqeror do të bëhet me lende plasuese të vendosura në bira sonde. Sonda e shpimit të birave vendoset në sheshin e sipërm të shkallës, për lartësi shkalle 10m birat do të shpohen 11, me diametër 89mm, largësia midis birave 4m dhe largësia midis rreshtave 3.5m. Produkti përfundimtar i projektit do të jetë gips i prodhuar në kariere.
Transporti	Ngarkimi i guri gëlqeror në sheshin e shkalleve do të bëhet me eskavator me zinxhira me madhësi kove 2m <sup>3</sup> , eskavatori vendoset në sheshin e shkallës së shfrytëzimit. Transporti deri në impjantin e thyerje fraksionimit bëhet me automjete me kapacitet transporti 16m <sup>3</sup> .
Lëndët e para	Lëndë e parë që prodhohet është guri gëlqeror që përdorë materiale ndihmese në kariere janë: -Energjia elektrike për ndricim në kariere -Energji elektrike për impjantin e thyerje fraksionimit të guri gëlqeror



	<p>- Panele Sanduici</p> <p>-Lende plasese te perdorimit civil dhe materiale plasese ne ditë.</p> <p>-Uje</p> <p>Uji perdoret vetem ne rastet per lagien e territorit ne menyre qe te mos kete krijim te pluhurave gjate veprimtarise sidomos ne kohe te thate dhe me ere, kjo sasi uji sigurohet permes depozitave te ujit qe shoqëria siguron per kete qellim. Lendet djegese qe perdorin mjetet e transportit sigurohet ne pikat e furnizimit me karburant.</p>
Shkarkimet e ujerave te dala nga proceset teknologjike	Nga aktiviteti i shfrytezimit te guri gelqeror nuk do të ketë shkarkime të ujrave të ndotura, sepse ne teknologjine e prodhimit te guri gelqeror me karriere nuk perdoret uji.



### Situata topografike e tokës së vënë në dispozicion të mjedisit përreth

Nga verifikimi në vend e kontrolli me dokumentacionin e projektit fillestar rezulton se subjekti ka në shfrytëzim sipërfaqen e tokës të përcaktuar në lejen e mjedisit. Subjekti nuk ka ndryshuar topografinë e zonës, përveç elementëve kur është ndërtuar objekti, duke bërë sistemimet sipas rekomandimeve të raportit të vlerësimit në mjedis e lejes përkatëse të mjedisit. Subjekti administron e mirëmban korrekt sipërfaqen e vënë në dispozicion të veprimtarisë me tërë infrastrukturën në shërbimin e saj. Shtrirja e vendndodhjes së subjektit është zona e përcaktuar nga koordinatat e mëposhtëme:

<i>Pikat</i>	<i>X</i>	<i>Y</i>
1	45 99 230	43 95 450
2	46 00 050	43 95 400
3	46 00 050	43 95 525
4	45 99 400	43 95 730

### ***Projekti i shfrytëzimit të minierës të mineralit***

Drejtimi shfrytëzimit të shkalleve do të bëhet pjesërisht nga lindja në jug dhe pjesërisht nga verilindja në drejtim të jug-perëndimit.

- Optimimi i guri gëlqeror në kariere do të bëhet me lende plasese të vendosur në bira sonde. Sonda gjatë shpimit të birave do qëndrojë në sheshin e sipërm të shkallës;
- Shpimi i birave bëhet paralel me skarpën e shkallës;
- Ngarkimi i prodhimit në frontin e punës bëhet me eskavator me zinxhira me madhësi kocke 2m<sup>3</sup>.
- Mjetet e ngarkimit gjatë punës qëndrojnë në sheshin e poshtëm të shkallës.
- Transporti i prodhimit nga karia deri në destinacion bëhet me automjete me kapacitet 16m<sup>3</sup>.



Mjetet e transportit gjatë ngarkimit qëndrojnë në sheshin e poshtëm të shkallës në një kuotë me mjete të ngarkimit të prodhimit. Në aspektin Urbanistik, objekti respekton distancat nga objektet ekzistuese kufiri i pronës, ai i rruges, etj. Objekti është projektuar nga pikepamja e zgjidhjeve teknologjike të realizuara materialisht, duke krijuar njëkohësisht një konfort ambjental dhe po ashtu të kursimit të burimeve energjitike. Shërbimet në këtë impiant kryhen në përputhje me procedurat dhe rekomandimet dhe plotësojnë normativat e Bashkimit Europian për cilësinë e produktit të ofruar. Objekti që vendoset në këtë zonë është konceptuar me volume, që realizojnë kohezionin me pëlhurën urbane ekzistuese dhe atë të perspektivës karakteristike. Të gjitha impiantet, pajisjet dhe mjetet teknike të përdorura për operimin e instalimit për të cilin është dhënë kjo Leje mbahen në kushte të mira funksionimi. Staf i profesional i kompanisë është i kualifikuar jo vetëm për shfrytëzim të mineralit të guri gëlqeror, por gjithashtu dhe në konsultim dhe orientim në përzgjedhjen e sakte të tyre për të plotësuar çdo kërkesë të klientëve. Subjekti ka punësuar një menaxher të arsimuar si person përgjegjës në përputhje me natyrën e punës dhe me përvojën e duhur. Personi përgjegjës është vazhdimisht i pranishëm në vendndodhje gjatë orëve të punës. Personi përgjegjës është i disponueshëm për tu takuar me personat e autorizuar të autoritetit kompetent në çdo kohë. Subjekti deklaron në Regjistrin e Shkarkimeve dhe Transferimeve të Ndotësve (RrShTN) çdo 6 muaj në AKM të dhënat për shkarkimet dhe transferimin e ndotësve që janë subjekt i këtij Regjistri.

### ***Dokumentacioni***

- Subjekti harton dhe mban dokumentacionin lidhur me menaxhimin e përbërësve të mjedisit për impiantin e tij në përputhje me aktet ligjore e nënligjore dhe kërkesat e autoritetit kompetent.
- Menaxhimi i informacionit mjedisor bëhet nga AKM/ARM sipas legjislacionit në fuqi.
- Subjekti i ofron një kopje të Lejes dhe kushteve të saj çdo personi, detyrat, kompetencat apo përgjegjësitë e të cilit lidhen me çfarëdo kushti të kësaj Leje.

### ***Veprimet Korrigjuese***

- Subjekti ka hartuar procedurat për kryerjen e veprimeve korrigjuese për rastet kur kushtet e përcaktuara në këtë Leje nuk janë përmbushur, përcakton çdo përgjegjësi dhe autorizon fillimin e hetimeve dhe veprimeve korrigjuese përkatëse.

### ***Trajnimi***

- Subjekti ka hartuar procedurat për identifikimin e nevojave për trajnim dhe zhvillon trajnime të përshtatshme për të gjithë punëmarrësit, puna e të cilëve mund të ketë ndikime të rëndësishme në mjedis. Të dhënat dhe dokumentacioni i trajnimeve i vihen në dispozicion inspektorëve.
- Punëmarrësit që kryejnë një detyrë kanë arsim, trajnim dhe përvojë të përshtatshme me natyrën e punës.
- Subjekti siguron që të gjithë punëmarrësit, janë të kualifikuar, të trajnuar dhe të njohur siç duhet me kushtet e kësaj Leje.

### ***Përgjegjësia***

- Subjekti ka siguruar praninë e një personi përgjegjës në çdo kohë gjatë operimit të shfrytëzimit të karrieres. Personi përgjegjës është i autorizuar dhe është i disponueshëm për të takuar çdo person të autorizuar nga Ministria, autoriteti kompetent apo inspektorati.

### ***Komunikimi***

- Subjekti ka hartuar procedurën për të siguruar që publiku të marrë informacion lidhur me performancat mjedisore në çdo kohë të arsyeshme.
- Subjekti i paraqet një Raport Vjetor të Mjedisit autoritetit kompetent çdo vit kalendarik. Ky raport, përfshin informacionin e specifikuar në Tabelën më poshtë (Përmbajtja e Raportit të Mjedisit).

### ***Marrëdhëniet me komunitetin e strukturat ligjore kontrolluese***

- Bazuar në kërkesat për procedura të tilla, rezulton se deri tani subjekti ka rakorduar në mënyrë të vazhdueshme e me korrektesë me strukturat përgjegjëse inspektuese.
- Njëkohësisht deri tani nuk ka patur probleme me komunitetin sa i takon impaktit mjedisor apo shqetësime të tjera që lidhen me këto.
- Njëkohësisht të bashkërendohet me strukturat e M.N.Z-së, Emergjencave Civile si dhe subjektet përreth për të zgjidhur problemet që lidhen me infrastrukturën e duhur mbrojtëse për evitim të ngjarjeve katastrofike.
- Subjekti disponon dokumentacionin e duhur që kërkohet për veprimtari të tilla, si dhe mban lidhje të vazhdueshme me strukturat kontrolluese të Inspektoriatit Qëndror Teknik, Inspektoriatit të Mjedisit.
- Realizon monitorimin periodik e dërgon materialet përkatëse sipas kërkesave ligjore.



### Aktivitetet në dobi të një zhvillimi të qëndrueshëm

- |   |   |
|---|---|
| • Asfaltimi i rrugës, brenda dhe jashtë impiantit | kryer jo i plote                          |
| • Gjelbërimi i zonës përreth impiantit            | ka filluar për tu kryer                   |
| • Funksionimi i impiantit                         | sipas modelit të miratuar në Leje         |
| • Kontrolli dhe furnizimi me ujë industrial       | nga rrjeti magjstral                      |
| • Mbrojtja në punë                                | sipas rregullave të teknikës së sigurimit |
| • Hartimi dhe zbatimi i rregulloreve përkatëse    | sipas rregullave                          |



Në hartimin e projektit teknologjik përfshihen:

- skema teknologjike, planimetria e objektit;
- skema e lidhjes së impiantit dhe prerjet në kuotat përkatëse;
- furnizimi me energji elektrike për fuqinë motorike dhe ndriçimin e ambientit të karrierës;
- mbrojtja e objektit nga rënia nën tension, nga shkarkimet atmosferike, si dhe të mbrojtjes nga zjarri;
- projekti ndërtimor i mjediseve të shërbimeve, i realizuar nga grupi i projektirneve të pjesës ndërtimore;

### Projekti tekniko – teknologjik

1. Subjekti ka ndërtuar të gjithë infrastrukturën që kërkohet nga kjo Leje, në përputhje me kushtet e saj, përpara fillimit të funksionimit të instalimit.
2. Subjekti në çdo pikë të shkarkimit ka parashikuar një vend për pajisjet e marrjes së mostrave apo të monitorimit, përfshirë pajisjet për mbledhjen e të dhënave dhe komunikimin siç kërkohet nga autoriteti kompetent.

***Ndërtimi i objektit të impiantit për prodhimin e guri gëlqeror realizohet nëpërmjet proceseve si me poshtë:***

1. Ndërtimi i trasese së rruges me gjatësi rreth 1000m dhe gjerësi 6m në territorin e karrierës do të bëhet me metodën e coptimit të guri gëlqeror me matrapik të montuar në krahun e eskavatorit. Trasea e rruges si

- kemi treguar dhe me siper do të ndertohet në teritorin e lejes minerare. Punimi do të hapet nga rruga ekzistuese ne kuoten +120m qe kalon ne gjith gjatesine e karieres dhe do të ngrihet deri ne kuoten +170m sheshin e shkalles se pare te shfrytezimit.
- Objektet e sherbimit do të ndertohen me konstruksion sanduici dhe do të vendosen në bazamente betoni ose trare ne lartesine 40cm nga toka.
  - Vaskat e dekantimit te llurbave do të hapen në sheshin fundor të karieres, me thellesi 2m, gjeresi 4m gjatesi 6m të rrethuara dhe të lidhura ne hyrje me kanal in e percjelljes së ujit të turbulluar dhe në dalje me kanal in e percjelljes së ujit të paster. Vaskat do të hapen me matrapik ose ne vartesi të fortesise së shkembtit me lende plasese të vendosura në birat e sondës.
  - Furnizimi me energji elektrike i objektit do të behet me nje lidhje të re nga linja ekzistuese tre fazore që kalon ne trasen e rruges dhe pershkon persegjati gjith pjesen veriore të objektit. Krahs linjes do të montohet kabina e transformacionit dhe paneli shperndares. Menyra e furnizimit të kabines nga linja elektrike tre fazore mund te behet me linje kabllore ose linje ajrore. Varianti me i mire do të percaktohet nga specialistet e OSHEE.

Objekti në vetvete ka karakterin e një objekti prodhues, në të cilin ndodhin procese fizike të transformimit të lëndës së parë në produkt të gatshëm. Gjatë këtyre cikleve bëhet kontrolli i ecurisë së punës. Radha e punës parashikohet të jetë si më poshtë:

- 1) Prgatitja e linjës së prodhimit;
- 2) Kontrolli i pajisjeve teknologjike;
- 3) Kontrolli i posteve të punës;
- 4) Kontrolli i sistemit të sigurisë;
- 5) Kontrolli i sistemit të mbrojtjes nga zjarri;

Subjekti ka siguruar akses të sigurt në të gjitha pikat e marrjes së mostrave dhe të monitorimit në vendndodhje dhe jashtë saj, në përputhje me kërkesat e autoritetit kompetent ose inspektoratit të mjedisit.

### **Treguesit kryesor të sistemit të funksionimit**

Mbrojtja nga rrymat elektrostatische të tubacioneve të linjave teknologjike të projektuara, realizohet nëpërmjet lidhjeve të konstruksioneve metalike të tyre tek pajisjet e sistemit të tokëzimit. Rezistenca e kalimit të rrymës, jo më shumë se 100 ohm. Projekti përfshin këto sisteme:

- Sistemi i mbrojtjes nga zjarri dhe hidrantët;
- Sistemi i mbrojtjes së mjedisit e dekoracioni;
- Sistemi i ujërave sipërfaqësore (të shiut, bores) dhe drenazhimet.
- Plani i ndërtimi të impiantit, ka marrë parasysh në masën maksimale respektimin e kriterëve mjedisore.
- Mbetjet e ngurta të gjeneruara janë parashikuar të menaxhohen sipas kriterëve të kohës dhe sipas një plani në përshtatje me kushtet konkrete të vendit.
- Projektimi i pajisjeve është bërë në përputhje të plotë me standartet më të mira ndërkombëtare dhe kjo rrit në nivele maksimale sigurinë në procesin e shfrytëzimit të karieres.
- I gjithë sheshi i impiantit është i pajisur me sistem drenimi dhe prita, si edhe sisteme të grumbullimit dhe filtrimit të ujërave të ndotura të shiut, duke ruajtur kështu mosndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe sistemeve hidrike nëntokësore në zonën e impiantit.
- Pozicioni i vendosjes se objektit është zgjedhur i tillë që të jep mundësi afrimi të përshtatshëm për shuarjen e zjarrit.





### **Impianti i MKZ**

Është një sistem, që shërben për mbrojtjen e objektit në rast rënie zjarri. Përbëhet nga rezervuari i ujit, ai i shkumës zjarrfikëse, pompa, ezhektorë dhe linjat e dërgimit të shkumës në rezervuar në rast zjarri. Shkuma duhet zgjedhur e cilësisë së lartë dhe e prodhimit të fundit. Ky instalim ka rol shumë të rëndësishëm dhe ka të bëjë me mbrojtjen e objektit nga zjarret e mundshme dhe gjithashtu në veçanti, atë të mbrojtjes së njerëzve, zonës përreth dhe të mjedisit. Impianti i zgjedhur është i tipit automatik, me panel komandues elektrik, pajisje për shuarjen e zjarrit (fikse të llojeve dhe madhësive të ndryshme, me shkumë, gaz karbonik dhe rërë kuarcore).

### **Këqyrja e pajisjeve që sigurojnë punën normale**

#### ***Këqyrja e pajisjeve që sigurojnë mbrojtjen e parkut nga zjarri***

- impiant stacionar shkumë sipas skemës
- shkuma sintetike e tipit "Metier 721".
- rezerva e ujit rreth 100m<sup>3</sup>.

#### ***Këqyrja e ndryshimeve apo rikonstruksioneve në teknologjinë e instaluar***

Gjatë periudhës së ndërtimit dhe shfrytëzimit janë vëzhguar këto parametra, ku është konstatuar se:

- ndryshime në ndërtim, nuk ka
- rikonstruksion për rritje të kapacitetit, nuk ka
- ndryshim në sipërfaqe dhe teknologji, nuk ka
- produkte të tjera përveç atyre të përcaktuara në licensën e shoqërisë (vetëm mineral gipsi, uje) nuk ka

## PLANI I PËRPUETHSHMËRISË DHE AFATET KOHORE

Subjekti ka zbatuar Planin e Përputhshmërisë siç përcaktohet në tabelën më poshtë. Përmbajtja e Planit të Përputhshmërisë dhe afatet kohore të zbatimit janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Plani i Përputhshmërisë						
Kushti Ref.	Veprimtaria e pajtueshmërisë	Kostot e investimit (EUR)	Fillim veprimitarisë (datë)	Fund veprimitarisë (datë)	Rezultate të veprimitarisë	Metodat e kontrollit
1	Blerja e uniformave për punonjesit	2500	2016	2019	Mbrojtja e punonjesve	Laboratori akredituar
2	Mbjellja e fidaneve autokton rreth zoneve të aktivitetit	60	2016	2019	Mbrojtja e mjedisit permiresimi i peisazhit	Laboratori akredituar
3	Mirembajtja e makinerive të punës	1000	2016	2019	Mirembajtja e instalimeve	Laboratori akredituar
4	Grumbullimi dhe sistemimi i ujrave të impiantit	1,000	2017	2018	Mbrojtja e mjedisit, permiresimi i peisazhit	Laboratori akredituar
5	Plani i menaxhimit të mbetjeve	1000	2017	-	Mbrojtja e mjedisit, permiresimi i peisazhit	Laboratori akredituar
		(Total)				

### Shkarkimi në ajër

Vlerat kufi për shkarkimet në ajër interpretohen si më poshtë:

#### 5.1.1. Monitorimi i vazhdueshëm:

- Asnjë vlerë mesatare për 24 orë nuk i tejkalon vlerat kufi të shkarkimit;
- 95% e të gjitha vlerave mesatare për 30 minuta nuk i tejkalon vlerat kufi të shkarkimit me më shumë se 20%;
- Asnjë vlerë mesatare për 30 min nuk i tejkalon vlerat kufi të shkarkimit më shumë se 2 herë.

#### 5.1.2. Monitorim jo i vazhdueshëm:

- Nëse për çfarëdolloj arsye, 30 minuta marrje mostre nuk është e mundur të realizohet subjekti zbaton një periudhë e përshtatshme të marrjes së mostrës, dhe vlerat e përfituara nuk i tejkalojnë vlerat kufi të shkarkimit.
- Për rrjedhjen, asnjë mesatare ditore nuk e tejkalon vlerën kufi.
- Për parametrat e tjerë, asnjë vlerë mesatare për 30 minuta nuk tejkalon vlerën kufi të shkarkimit.
- Pragjet e rrjedhjes në masë i referohen shkarkimeve të shprehura në njësi të kg/orë mbi të cilat zbatohet vlera kufi e shkarkimit të përqendrimit.
- Vlerat prag të rrjedhjes në masë llogariten mbi bazën e përqendrimit të përcaktuar si një mesatare në një periudhë të dhënë të shumëzuar me një matje të përshtatshme të rrjedhjes. Asnjë vlerë e përcaktuar në këtë mënyrë nuk i tejkalon vlerën kufi të përcaktuar të rrjedhjes në masë.

5.2. Vlerat kufi të përqendrimit për shkarkimet në ajër të përcaktuara në këtë Leje janë bazohen në vëllimin e gazit në kushte normale:

5.2.1. Gazet jo të ndezshme:

a) Temperatura 273K, trysnia 101.3kPa (pa korrigjim për oksigjenin ose përmbajtjen e ujit).

5.2.2. Gazet e ndezshme:

a) Temperatura 273K, trysnia 101.3kPa, gaz i thatë; 3% oksigjen për karburantet e lëngshme dhe të gazta, 6% oksigjen për karburantet e ngurta.

***Në veprimtarinë e punës nuk kemi përdorim të lëndëve djegëse (qymyr apo nafte) apo përpunime të materialeve të tjera që mund të shoqërohen me shkarkime në ajër sepse punohet me energji elektrike. Veprimtaria është e tillë që shmang shkarkimin e pluhuri.***

**Vlerat kufi të shkarkimit në ujë:**

Matje e vazhdueshme:

- a) Asnjë vlerë e pH nuk është jetë jashtë gamës së specifikuar.
- b) Asnjë vlerë e rrjedhjes nuk e tejkalon kufirin e specifikuar.

Matje jo e vazhdueshme:

- a) Anjë vlerë e pH nuk është jashtë gamës së specifikuar.
- b) Asnjë vlerë e temperaturës nuk e tejkalon vlerën kufi.
- c) Për të gjithë parametrat përveç pH-it, temperaturës dhe rrjedhjes, asnjë mostër mesatare ditore nuk i tejkalon vlerat kufi të shkarkimit të specifikuar në Shtojcën 3 të Ligjit për Lejet e Mjedisit.
- d) Për të gjithë parametrat përveç pH-it, temperaturës dhe rrjedhjet, asnjë mostër e rastësishme nuk i tejkalon 1.2 herë vlerat kufi të shkarkimit të përcaktuara në Shtojcën 2.1 dhe/ose 3.1.

- Shkarkimet e lëngëta si ujëra sipërfaqësore e ato higjeno-sanitare janë të orientuara në pusetat e zonës konform kërkesave ligjore.
- Masa e ngurtë e mjediseve të higjenës vetiake është zgjidhur me destinacion drejt kanalit që pastrohet rast pas rasti sipas një grafiku nga subjektet e kontraktuara e licensuara.
- Kompania kryen analizimin periodik të shkarkimeve të ujerave të grumbulluara në vaskat e dekantimit;
- Nuk shkarkohet në kanalizime çfarëdolloj lëndë në përqendrime të cilat janë të rrezikshme për shëndetin e personelit të mirëmbajtjes së kanalizimeve.
- Asnjë substancë ose përqendrim i cili pas hollimit fillestar në një ambient pritës mund të jetë i dëmshëm për jetën ujore nuk shkarkohet në kanalizime.
- Subjekti i krijon mundësi personelit të autorizuar nga autoriteti kompetent që të inspektojë, kontrollojë ose testojë çdo operacion ose pajisje në çdo kohë (moment) të arsyeshme në lidhje me ujërat e ndotura ose që të marrë mostra të ujit i cili është objekt i kushteve të kësaj Leje.

Subjekti nuk shkarkon lëndë të lëngshme ose lëngje të tjera që mund të ngecin ose të ngurtësohen në temperaturën mesatare të ujit të kanalizimit ose mund të krijojnë gazra që marrin flakë ose që janë shpërthyes ose acide, alkaline apo substanca të tjera në përqendrime që mund të shkatërrojnë tubat e kanalizimeve dhe pajisjet e tyre ose ti dëmtojnë ato në mënyra të tjera.



Asnjë substancë ose përqendrim i cili pas hollimit fillestar në një ambient pritës mund të jetë i dëmshëm për jetën ujore ***nuk shkarkohet në kanalizime.***

Subjekti i krijon mundësi personelit të autorizuar nga autoriteti kompetent që të inspektojë, kontrollojë ose testojë çdo operacion ose pajisje në çdo kohë (moment) të arsyeshme në lidhje me ujërat e ndotura ose që të marrë mostra të ujit i cili është objekt i kushteve të kësaj Leje.

### **Ndikimi nga zhurmat**

Zhurma nga instalimi nuk i kalon nivelet e përcaktuara nga legjislati në fuqi për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në Shqipëri.

Zhurmat që krijohen në këtë aktivitet si rezultat i punës së paisjeve e makinerive si cekic shpues, fadrome dhe mjete të transportit. Të gjitha keto mjete janë objekt i kontrollit teknik periodik, perfshi dhe nivelin e zhurmave.

Zhurma gjithashtu emetohen dhe gjatë punëve me lende plasese. Keto zhurma clirohen në një kohë të shkurter, dhe nuk ndikojnë tek punonjesit, sepse punonjësit janë larg në siperfaqe të punimeve.

- ***Në këtë veprimtari krijohen zhurmat e vibracione, brenda normave të lejuara sepse përdoren makineri-pajisje që kanë intensitet të ulët të zhurmës.***
- Vibracionet gjatë punës në impiant ka, sepse përdoren proceset e shpimit me lende plasese duke krijuar vibracione me kohe zgjatje të shkurter.
- Subjekti nuk ka në afërsi zonë të banuar mjedisore publike si shkolla, spitale, etj.

### **NJOFTIMET**

1. Subjekti nuk ka konstatuar probleme në lidhje me çfarëdolloj shkarkimi të substancave apo çfarëdolloj burimi potencial, i cili i tejkalon normat.
2. Për këtë arsye nuk ka qënë e nevojshme njoftimi i AKM ose Inspektoriatit të Mjedisit.

### **SHKARKIMET**

**Shkarkimet në ajër** - Shkarkimet në ajër nuk do të kemi gjatë operacioneve të punimit.

1. Në veprimtarinë e punës nuk kemi përdorim të lëndëve djegëse ndaj ky aktivitet nuk shoqërohet me emetime në mjedis. Veprimtaria është e tillë që nuk shoqërohet me shkarkim pluhuri.
2. Gjate fazes normale te operimit te projektit nuk do te kete emetime te gazeve, lengjeve, mbetjeve toksike, helme te ndryshme dhe substanca te tjera te demshme, te cilat mund te ndikojne negativisht ne shendetin e punonjesve, banoreve dhe mjedisin perreth, floren dhe faunen e zones, burimet ujore. Shfrytezimi i guri gelqeror me kariere eshte nje proces i thjeshte pune coptim shkemi me lende plasese te vendosur ne bira sonde, ngarkim te prodhimit me eskavator dhe transport me kamione. Meqenese nuk do te perdoren ne procesin e shfrytezimit lende te demshme, nuk do te kete shkarkime te lendeve kimike te demshme per mjedisin ne ajer, toke dhe uje. Siperfaqja qe do t'i nenshtrohet shfrytezimit nuk eshte toke bujqesore produktive. Ushtrimi i aktivitetit ne kete siperfaqe nuk ndikon negativisht ne cilesine dhe sasine e tokes bujqesore. Tokat bujqesore ndodhen jasht zones ku do te kryhet aktiviteti.
3. Subjekti kryen monitorimin dhe analizën për çdo shkarkim nga pikat e shkarkimit dhe të paktën në intervalet e specifikuar. Analiza kryhet nga /mjete të kalibruara ose në rastin e monitorimit vazhdueshëm matjet kryhen nga një ekspert ose laborator i çertifikuar.

4. Të dhënat e monitorimit të cilësisë së ndotjes së ajrit tregojnë se aktiviteti i subjektit të mësipërm ka karakteristikat e një prodhimi industrial me proces që shkakton ndotje në ujrat sipërfaqesore. Niveli i grimcave dhe i gazeve kryesore ndotës në ajrin brenda tij dhe në kufirin ndarës me mjedisin rrethues është disa herë më i ulët se përmbajtja e lejuar e tyre në mjediset e punës sipas legjislacionit shqiptar (*Lista e limiteve të lejueshme të përqendrimeve të gazeve, avujve dhe pluhurave helmuese në ajrin e ambienteve të punës, Ministria e Shëndetësisë, Tiranë 1998*). Aktiviteti nuk ka shkarkime në ajër nga oxhaqe teknologjike. Impianti mund të konsiderohet pa probleme lidhur me ndikimin në cilësinë e ajrit mjedisor.

**Shkarkimet në ujë** - Shkarkimet në ujra nuk do të kemi gjatë operacioneve të punimit

**Përbërës të formave të ndotjes në ujë:**

- cipash notuese, nuk vërehet
- në forme emulsionesh nuk vërehet
- në gjendje të tretur nuk vërehet

**Shkarkimet në kanalizime**

- Subjekti i krijon mundësi personelit të autorizuar nga autoriteti kompetent që të inspektojë, kontrollojë ose testojë çdo operacion ose pajisje në çdo kohë (moment) të arsyeshme në lidhje me ujërat e ndotura ose që të marrë mostra të ujit i cili është objekt i kushteve të kësaj Leje.
- Ndalohet shkarkimi i substancave të cilat shkaktojnë reaksione kimike ose krijimin e ndërmjetësve që janë të rëndësishëm për mjedisin.

## **MENAXHIMI I MBETJEVE**

**Menaxhimi i mbetjeve të ngurta**

- Të gjitha mbeturinat e ngurta derdhen në kazanët përkatës.
- Gjithsesi, për mbetjet urbane janë marrë masat që të çohen në vendin e caktuar nga Bashkia, brenda të gjitha normave të lejuara.
- Në këtë impiant ndodhen disa kosha, të cilët kryejnë funksionin e grumbullimit të mbeturinave. Skarcitetet të cilët futen përsëri në prodhim, hidhen në kosha më vete dhe më pas hyjnë përsëri në punë, ndërsa mbetjet e ndryshme të paketimeve të produkteve që kompania përdor për procesin e prodhimit dhe mbetje të tjera, hidhen në kosha të posaçëm, për tu çuar më pas në destinacionin e caktuar sipas rregullave.

Veprimtaria e këtij aktiviteti do të shoqërohet me keto lloj mbetjesh:

- Mbetje të ngurta nga procesi teknologjik. Në vendet e caktuara në projekt (depozitat e sterileve) parashikohet depozitimi i materialit të përdorshëm dhe perpunimi i tij me toke vegjetale për të mundësuar mbjelljen e bimeve dhe pemëve karakteristike të zonës gjatë fazës së rehabilitimit. Dhërat e depozituara në damba do të perpunohen me dhëra të pasuruara me humuse, do të transportohen dhe shpërndahen në sheshet e shkalleve me trashësi mbi 20cm dhe do të pyllëzohen me bime që rriten në zone për gjelberimin e saj

**Ndikimet nga mbetjet apo mbeturinat që krijohen**

- Llojet, sasi, data dhe mënyra e largimit të të gjithë mbeturinave të rëndësishme do të shënohet në një regjistër dhe puntorëve do t'u kërkohet të mbledhin veç fraksionet e ndryshme të mbeturinave.

<b>Asgjësimi/trajtimi i mbetjeve të tjera</b>				
Mbetja	Numri i katalogut	Trajtim i mëtejshëm në vendndodhje	Ripërdorimi, riciklimi ose trajtimi në vendndodhje	Metoda e asgjësimit/trajtimit jashtë vendndodhjes
Mbetje pluhurash, të tjera nga ato të përmendura në 01 04 07	01 04 10	Nuk kryhet trajtim i mëtejshëm në vendndodhje.	Ripërdorim për rehabilitimin e objektit mineral	
Letra e Karton Qelq	20 01 01 20 01 02	Nuk kryhet trajtim i mëtejshëm në vendndodhje		Grumbullim, Transportim në kontener të mbetjeve urbane të Njësisë vendore
Plastikat	20 01 39	Nuk kryhet trajtim i mëtejshëm në vendndodhje		Grumbullim, Transportim në kontener të mbetjeve urbane të Njësisë vendore

*Në rastet e shkarkimeve dhe rrjedhjeve aksidentale të lubrifikantëve, të bëhet menjëherë kapja dhe izolimi i tyre në kontener të mbyllur hermetikisht dhe asgjësimin përfundimtar të tyre nga subjekte të licënuara.*

*Në rastet e gjenerimit të mbetjeve të rrezikshme, njoftohet AKM-ja brenda 3 ditëve Pune për tipin, llojin, sasinë dhe vendin e gjenerimit, të bëhet izolimi i menjëhershëm i tyre dhe asgjësimi përfundimtar nga subjekte të licënuara.*

#### **Mbetjet e ruajtura në vendndodhjen**

<i>Pershkrimi i Mbetjes</i>	<i>Vendndodhja e vendit të ruajtjes</i>	<i>Mënyra e ruajtjes</i>	<i>Kushtet e ruajtjes</i>
Mbetjet e guri gelqeror që dalin nga proceset që zhvillohen për shfrytëzimin e objektivit mineral.	Mbetjet e guri gelqeror do të ruhen brenda zonës së shfrytëzimit.	Në asnjë rast nuk kemi shkarkime të guri gelqeror jashtë zonës së miratuar, nuk kemi perzierjen e tyre me lende të ndotura dhe nuk kemi rrjedhje të ujërave të ndotura.	Jane monitoruar periodikisht venddepozitimi i mbetjeve në mënyrë parandalimi rrjedhje në mjediset e tjera ngjitur.

#### **ZHURMAT DHE VIBRACIONET**

**Zhurma** - Zhurma do të ketë gjatë procesit të punës së copezimit të mineralit dhe transportimit. Ato do të jenë prezent gjatë kohës së funksionimit të tij, madje brenda normat e lejuara të zonave industrialë.

**Lëkundje** - Lëkundje nuk do të ketë, sepse pajisjet lëvizëse janë shumë të pakta në numër dhe me fuqi të ulët dhe me konstruksione, që garantojnë punë në ekuilibër të plotë.

**Vibracione** - Vibracionet nuk ka prej punës në pajisjet teknologjike sepse janë të miremajtura, si dhe për shkak të funksionimit bashkëkohor të pajisjeve. Gjatë procesit të punës vibrimet nuk i kalojnë normat e lejuara 10mm/s (PPV) në çdo kohë.



### **Makinerit dhe niveli i pranueshem i zhurmave**

<b>Lloji makinerise</b>	<b>fuqia motorike P (kw)</b>	<b>niveli pranueshem i zhurmes db</b>
<b>Eskavator me zinxhira Fadrome, kamion me vinc Shkarkues</b>	<b>p = 55</b>	<b>65</b>
<b>Eskavator, paisje ngritese Transportues, sonde, etj</b>	<b>p = 15</b>	<b>68</b>
<b>Gjenerator saldimi</b>	<b>p = 10</b>	<b>55</b>
<b>Kompresor</b>	<b>p = 15</b>	<b>45</b>
<b>Matrapik ne eskvator</b>	<b>p = 15</b>	<b>75</b>

### **Ndikimi nga zhurmat e vibracionet**

- Në këtë veprimtari janë jo të larta zhurmat e vibracionet, sepse përdoren makineri-pajisje që kanë intensitet të ulët të zhurmës.
- Vibracionet gjatë punës në impiant nuk ka, sepse është zgjedhur teknologjia e impiantit.
- Subjekti nuk ka në afërsi zonë të banuar mjedisore publike si shkolla, spitale, etj.

### **Reduktimi i efekteve negative nga Zhurmat**

Vlerësimi i masave për zbutjen e ndikimeve negative të zhurmave dhe dridhjeve vërehet se janë bërë këto masa zbutëse si:

**Lidhur me teknologjinë**

sipas normave të KE

**Lidhur me mjetet e transportit,**

e vetmja zgjidhje për këto raste është kufizimi i shpejtësisë dhe lejimi i automjeteve me gjendje të mirë në respekt të normave të kontrollit fizik.

**Lidhur me rrugën,**

zgjidhja në këtë rast është gjetur duke kryer me cilësi shumë të mirë e asfaltit, pa andra, me sipërfaqe jo të ashpër.

**Lidhur me faktorët mjedisorë,**

është kryer linjëzimi me shkurre dhe pemë, por duhen më të dendura.

**Sipërfaqeja e jashtme, mirëmbajtja**

Kontroll viziv periodik te shesheve te punes dhe kontrolli i gjendjen higjieno sanitare te vendeve te punes.

Identifikimi i masave zbutëse që zbatohen për të minimizuar efektin e parashikuar të sejcilit aktivitet konsiderohen si praktika të mira inxhinerike dhe praktikat më të mira të menaxhimit të problemeve të ndikimit në mjedis.

## **LËNDËT E PARA DHE SHFRYTËZIMI I ENERGJISË**

Subjekti kryen *auditimin e efikasitetit të energjisë* brenda një viti pas lëshimit të Lejes. Impianti punon me energji elektrike të siguruar nga rrjeti dhe nuk përdor asnjë alternative tjetër energjie, pasi vetë funksionimi i makinerisë është i destinuar me një lëndë bazë të tillë. Nga studio laborator ECCAT me qendër në Tiranë me porosi të Kompanisë "PASHA – X", Sh.p.k., me aktivitet shfrytëzim në qiell të hapur të gurit gëlqeror nga guroret, me vendodhje aktiviteti Adresa: Burizane, Zona Minerare konkurruese Nr. 379/2, Koder Thumane, Krugë, u realizuan matjet e nivelit të zhurmave të prodhuara nga aktiviteti i subjektit në mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm të tij, nga puna gjatë aktivitetit prodhues, dt. 28.07 2018. Matjet e zhurmave u bënë për 10min., për vlerësimin e zhurmës së krijuar nga ky subjekt gjatë ditës, në mjediset e brendshëm dhe të jashtëm të impiantit gjatë regjimit normal të punës së aktivitetit zhurmë prodhues prej orës 09:24-09:34. Matjet ishin të karakterit

integral me kohë të shkurtër. Aparati i përdorur për matje është "Pulsar Nova 45" i tipit Sound Level Meter I cili është një aparat I CLAS-it I, me një korrigjim  $\pm 1.5$  dB(A) që mundëson njohje automatike të intervalit, dy mundësi integri në frekuencat dhe mundësi leximi të vlerës minimale dhe maximale. Standarti i përdorur për matjen e nivelit të zhurmës është: ISO 1996-2: 2007 Acoustics-Description, measurement and assessment of Environmental noise.

### Pika 1.

Vendi	Pika 1. Lat: 40694499; Lon: 19983764	LAeq	59.9 dB
		Limit LAMax	110 dB
Koha	10/07/2018 09:24 AM	LAeq. Tdit	70 dB
Zgjatja	00:10:00 AM	LAFMax	73.8 dB
Instrument	G056530, CR:161B	Kalibrimi	LAFMin
	10/07/2018 09:00:47		54.8 dB

### Rezultati

Lidhur me nivelet e matur te zhurmave, matjet ne impiant rezultojne në LAeq mesatar prej 59.9dB dhe LAF max. 67.6 dB, që jane nen kufirin e lejuar prej LAeq 70 dB dhe LAFmax 110 dB, sipas Udhezimit Nr.8, date 27.11.2007 të MMPAU dhe MSH "PER NIVELET KUFIT TE ZHURMAVE NE MJEDISE TE CAKTUARA". Distanca e konsiderueshme prej objekteve te banimit (>500m) është garanci që edhe atje niveli i zhurmes prej ketij aktiviteti gjendet brenda normes se rekomanduar prej legjislacionit tone. Aneksi 1 Udhezimi Nr.8, date 27.11.2007 te MMPAU dhe MSH "PER nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara".

Mjedisi	Efekti kritik në shëndet	LA <sub>eq</sub> (dBA)	Koha bazë (orë)	Lamax Fast (dB)
<b>Zona banimi</b>				
Jashtë banese	Bezdi (shqetësim) serioze gjatë ditës dhe mbrëmjes	55	16	-
	Bezdi (shqetësim) i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	50	16	-
Në brendësi të banesave	Kuptueshmëri e bisedës dhe (bezdi) shqetësim i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	35	16	-
Në brendësi të dhomës së fjetjes	Prishja e gjumit natën	30	8	-
Jashtë dhomës së fjetjes	Prishje e gjumit, dritare e hapur (vlera nga jashtë)	45	8	-
<b>Zona me aktivitetet social-ekonomik</b>				
Zona industriale, tregtare, qarkullim trafiku (mjedis i jashtëm, brendshëm)	Dëmtim dëgjimi	70	24	110
<b>Mjedisi urban</b>				
Mjedise publike, të jashtme apo të brendshme	Dëmtim dëgjimi	85	1	110

Shpjegime:

LAeq (dBA) = Niveli ekuivalent i matur në shkallën A.

Koha bazë (orë) = Koha gjatë së cilës bëhet matja.

Lamax Fast (dB) = Niveli i matur në shkallën A në mënyrën fast (e shpejtë)

## **Përfundime**

1. Ushtrimi i këtij aktiviteti në kushte normale e në zbatim të projektit të shfrytëzimit nuk do të ndikojë në nivelin e ujërave, në rruget ujore dhe në rrjedhjen e ujërave nentoksore. Në këto zone aktiviteti, e afërsisht nuk ka burime uji nentoksore apo pasqyrim të karakterit hidrogeologjik për ujë të pishëm.
2. Subjekti "PASHA - X" sh.p.k Burizane, ka intensifikuar punën për përmirësimin e nivelit teknologjik, për rritjen e prodhimit, cilësisë së tij dhe koston,
3. Subjekti raporton çdo 6 (gjashtë) muaj pranë AKM-së, për ecurinë e punimeve dhe plotësimin të kushteve të lejes.
4. Punimet kryhen vetëm në sipërfaqet e përcaktuara në raportin teknik.
5. Zbatohet me rigorozitet projektin inxhinierio-teknik.
6. Kontrollon nga drejtuesi teknik dhe personeli tjetër drejtues i subjektit, mbajtja e pajisjeve mbrojtëse individuale nga ana e punonjësve.
7. Monitoron nivelin e zhurmave gjatë fazës operacionale, sipas udhëzimit nr. 8, datë 27.11.2007 "për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara".
8. Respektohen rregullat dhe standartet teknike të operimit të punës, jo herët në mëngjes dhe jo vonë në mbrëmje, me qëllim reduktimin e zhurmave në zonën përreth.
9. Zbatohen normat ligjore për shkarkimet në ujë, tokë dhe ajër.
10. Nga aktiviteti që ushtrohet nuk ka ndikim negativ për popullatën përreth.
11. Kontrollon kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për evitimin, parandalimin emetimin e gazeve dhe zhurmave të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve.
12. Parkimi i mjeteve dhe ruajtja e makinerive bëhet vetëm brenda sipërfaqes së objektit dhe në vendin e përcaktuar.
13. Automjetet përdorin naftë cilësore me përmbajtje të S, Pb, brenda standardeve për të evituar ndotjen e ajrit gjatë qarkullimit.
14. Makineritë janë të pajisura me sistemin mbrojtës nga zhurmat.
15. Subjekti është i pajisur me një impiant (MKZ), për të parandaluar rëniet e zjarrit gjatë realizimit të punimeve në terren (shpime, cigare etj)

## **Për veprimatrinë e tij në ruajtjen e mjedisit Kompania arrin:**

1. Të kontrollojë e sistemojë ujërat dhe masën e ngurtë që krijohet nga ujërat sipërfaqësore, me dekantim përpara shkarkimit të tyre në mjedisin ujor pritës.
2. Në bashkërendim me strukturat përgjegjëse, ai ndjek grafikun e kontrollit, si dhe gjithë elementet që lidhen me zbatimin e rregullores së sigurimit teknik.
3. Të ndjek e zbatojë kodin e punës për veprimtari të tilla, si dhe kontrollon infrastrukturën përkatëse të aksesoreve të sigurisë, që të evitojë katastrofat e mundshme.
4. Të mirëmbajë e të kenë në gadishmëri pajisjet e infrastruktura përkatëse për MNZ-në, si dhe të rifreskon vazhdimisht skemat funksionale e të veprimeve në raste aksidentesh industriale për të evituar ngjarje të emergjencave, me trajnime të personelit, etj.

Përfundimisht, theksojmë se të dhënat e këtij monitorimi ballafaqar me normat ligjore të shkarkimit në mjedis, tregojnë për një vlerësim gjithnjë në rritje në drejtim të ruajtjes së mjedisit dhe shëndetit nga kjo shoqëri. Matjet janë realizuar nga Ing. Kimist Alma Shehu, për zhurmat dhe cilesinë e ujërave nentoksore.